

Republika e Shqiperise
Gjykata Administrative e Shkalles se Pare
K O R Ç E

Nr 667-00969 Regj.Them
Data e regj 17.06.2016

Nr 1205-(482) Vendimi
Data 21.10.2016

V E N D I M
“Ne emer te Republikes”

Gjykata administrative e shkalles se pare Korçe e perbere prej:

Kryetare e seances gjyqesore - **ETLEVA GJAMO**

asistuar nga sekretare e seances gjyqesore Safjola Sadik ne Gjykate, ne date 21.10.2016, ora 12 20 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen administrative me nr 667-00969 rregjistri themeltar , date 17.06.2016 rregjistrimi qe i perket:

PADITES: **Subjekti tatimpagues “Health Diagnostik Center Crasis” sh.p.k** ,
me seli ne Korçe, Lagja nr 3, Bulevardi “Fan Noli”, nr 15, perfaqesuar me
autorizim nga Edlira Pilika.

E PADITUR: **Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe**, perfaqesuar me autorizim nga juriste
Mirela Veriga.

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ „Akt njoftim vlerësimi per
detyrimet tatimore nr 9521 prot date 25.02.2016 te DRT Korçe dhe vendimin
nr 8510/1 prot date 18.05.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor prane DPT
Tirane.

BazaLigjore: Neni 324 e vijues i K.Pr.C, neni 106,107,108,109 te ligjit nr 9920 date
19.05.2008 „Per procedurat tatimore „, i ndryshuar, neni 116 e vijues i
K.Pr.Administrative.

Ne perfundim te gjykimit te zhvilluar ne prani te perfaqesueses me autorizim
paditesit dhe perfaqesueses me autorizim te pales se paditur, ne pretendimet perfundimtare te
depozituara me shkrim, perfaqesuesja e paditesit ka kerkuar pranimin e padise, perfaqesuesja
e pales se paditur kerkoi rezimin e padise.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet dhe bisedoi çeshtjen ne teresi.

V E R E N

Nga aktet bashkangjitur kerkese padise ka rezultuar se “Health Diagnostik Center
Crasis” eshte regjistraur si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar prrej dates 29.01.2015 me
objekt te veprimtarise”Sherbime mjeksore ne fushen e gastroenterologjise, imazheri,

diagnostikim kardiologjik etj ” me perfaqesues ligjor Savvas Tsivelekidis, aktivitet te cilin e ushtron ne Korçe ne Lagjen nr 3, Bul “Fan Noli”, objekti nr 15.

Ne daten 12.02.2016 nga Inspektoret e Drejtorise se Hetimit Tatimor te DPT Tirane eshte ushtruar kontroll ne vendin e ushtrimit te veprimtarise, dokumentuar me “Akt konstatimi” date 12.02.2016 ku nder te tjera evidentohet fakti se subjekti ka te instaluar pajisjen fiskale , leshon kupon tatimor por nuk ka te afishuar posterin per terheqjen e kuponit tatimor.

Mbi te dhenat e aktit te konstatimit, ne daten 13.02.2016 nga Inspektoret e DRT Korçe eshte mbajtur “Procesverbal gjobe” dhe ne baze te nenit 122, pika 1, germa d) e ligjit nr 9920, date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, subjekti eshte denuar me gjobe ne masen 20 000 leke, per mosafishim te posterit per terheqjen e kuponit tatimor.

Ne daten 19.02.2016 Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe ka nxjere “Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore” me te cilin shoqerise i kerkohet pagesa e gjobes prrej 20 000 leke, i cili i eshte njoftuar subjektit me shkresen nr 18103/2 prot date 06.07.2016.

Shoqeria nuk ka qene dakord me “Njoftim vleresimin e detyrimit tatimor -gjobe” dhe ka paraqitur ankim ne Drejtorine e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane.

Kjo e fundit me vendimin nr 8510/1 date 18.05.2016 ka rezuar ankimin duke lene ne fuqi Njoftim vleresimin per detyrimet tatimore te DRT Korçe.

Ne daten 16.06.2016 shoqeria ka paraqitur ne gjykate padine objekt i ketij gjykimi me te cilin kerkon “Shfuqizimin e njoftim vleresimit per detyrimet tatimore ”.

Lidhur me kerkimin per shfuqzimin e aktit administrativ , si ne padi dhe gjate gjykimit, paditesi konteston “Njoftim vleresimin tatimor” me aresyetimin se ne daten e ushtrimit te kontrollit Inspektoreve te Drejtorise se Hetimit tatimor ju eshte vene ne dispzicion gjithë dokumentacioni i kerkuar dhe pas verifikimit ne detaje, u mbajt akti i konstatimit me aresyen se tatimpaguesi nuk ka te afishaur posterin per terheqjen e kuponit tatimor dhe mandej shoqeria u njoftua per denimin me gjobe.

Megjithe ankimin e paraqitur ne Drejtorine e Apelimit, denimi u la ne fuqi edhe pse gjoba u vendos ne menyre abuzive pasi shoqeria eshte kontrolluar edhe dy here te tjera me pare dhe nuk eshte konstatuar mosafishimi i posterit per terheqjen e kuponit, pasi posteri ka qene ne te njejtin vend dhe i hartuar ne perputhje me ligjet ne fuqi. Akti i konstatimit eshte nenshkruar nga dy punonjes te cilet nuk ka qene prezent ne momenetin e ushtrimit te kontrollit dhe nuk ka patur perfaqesues te Drejtorise Rajonale Tatimore ne momentin e ushtrimt te kontrollit dhe mbajtjes se aktit te konstatimit sic parashikon ligji. Persa me siper njoftim vleresimi eshte absolutisht i pavlefshem dhe duhet te anulohet.

Perfaqesuesja e pales se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe gjate gjykimit prapesoi se ne momentin e ushtrimit te kontrollit tatimor gjendja e konstatuar u pasqyrua ne aktin e konstatimit lidhur me faktin seshoqeria nuk kishte te afishuar posterin per terheqjen e kuponit tatimor. Pretendimi i shoqerise se ka patur te afishuar posterin nuk mund te vertetohet ne nje moment te dyte pasi kontrolli eshte ushtruar nga punonjës qe e kane patur tagrin per te ushtruar kontrolle dhe per te vendosur gjoba ne rast te konstatimit te kundravajtjeve administrative. Pretendimi i pales paditese se kontrolli u krye pa prezencen e inspektoreve te DRT Korçe nuk gjen mbeshtetje ligjore pasi ne baze te akteve nenligjore , udhezimeve dhe manualeve te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve gjobat vendosen nga inspektoret e

kontrollit te pajisur me urdher pune, por gjobat vendosen edhe nga punonjes te tjere te autorizuar per kete qellim. Ne baze te nenit 80.3 te ligjit 9920 date 19.05.2008 dhe Udhezimit nr 24 date 02.09.2008 Inspektoret e verifikimit ne teren kryejne verifikime ne vendin e ushtrimit te aktivitetit me qellim zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me veprimtarine e tatimpaguesit dhe akti i konstatimit eshte mbajtur ne zbatim korekt te ligjit 9920 date 19.05.2008 si dhe ligjit nr 10 279 date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative". Tatimpaguesi ka shkelur norma ligjore pasi nga Inspektoret e DRT u konstatua kundravajtja administrative e parashikuar nga nenit 122 i ligjit 9920 date 19.05.2008 dhe padia e tij duhet te rezohet .

Gjykata pasi shqyrtoi pretendimet e paditesit , prapesimet e pales se paditur si dhe provat e sjella prrej tyre, bazuar edhe ne percaktimet e nenit 16 te Kodit te Procedures Civile ne lidhje edhe me nenin 17/2 te ligjit 49/2012 çmon se padia e paditesit eshte e bazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille duhet te pranohet.

Neni 15, germa a) e ligjit 49/2012 parashikon se te drejten e ngritjes se padise e ka çdo subjekt qe pretendon se i eshte cenuar nje e drejte ose interes i ligjshem nga nje veprim ose mosveprim i organit publik, ndersa neni 17 pika 1, germa c) parashikon se padia mund te ngrihet per te kerkuar konstatimin e pavlefshmerise absolute te organit administrativ.

Lidhur me afatin e ngritjes se padise gjykata e vlereson padine e paditesit te paraqitur ne perputhje me parashikimet e nenit 18 i ligjit 49/2012, i cili ne piken 8 parashikon se padia per konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit administrativ mund te ngrihet ne çdo kohe, qendrim qe ka mbajtur gjykata e Larte edhe ne vendimin Unifikues nr 3/2008.

Pervec sa me siper per efekt te shqyrtimit te bazueshmerise ligjore te pretendimeve te paditesit dhe prapesimeve te te paditurit gjykata mban parasysh edhe percaktimet e nenit 35.1 te ligjit 49/2012 i cili parashikon se organi publik ka detyrimin te provoje **ligjshmerine e aktit administrativ**, kontrates administrative dhe te veprimit administrativ te nxjere jo me kerkese te paditesit si dhe **faktet** qe ai ka parashtruar dhe ka vene ne themel te veprimtarise se kundershtruar ne gjykate.

Pala paditese pretendon se denimi me gjobe eshte abuziv pasi ne momentin e ushtrimit te kontorolit ka patur te afishuar posterin per njoftimin e klienteve per terheqje te kuponit tatimor si dhe pretendon se kontrolli eshte ushtruar pa pranine e perfaqesuesit te DRT Korçe, pretendim i cili ne vetvete i referohet kopetences se Inspektoreve te Drejtorise se Hetimit ne ushtrimin e kontorlleve qe lidhem me zbatimin e nenit 122 te ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise i ndryshuar".

Ne kete aspekt per efekt te çmuarjes se bazueshmerise ligjore te pretendimeve te pales paditese gjykata do te mare ne analize pretendimin per pavlefshmerine absolute ne raport me rrethanat faktike te çeshtjes objekt gjykimi.

Ne kuptim te nenit 116 te Kodit te Procedurave Administrative , aktet administrative do te quhen absolutisht te pavlefshme ne rastet e meposhtme:

- a) Kur akti eshte nxjere nga nje organ administrativ i pidentifikuar.
- b) Kur akti eshte nxjere nga nje organ administrativ ne kapercim te kopetencave te tij ligjore.

c) Kur akti është nxjere nga nje organ administrativ ne kundërshtim me formen dhe proceduren e parashikuar nga ligji.

Ne kuptim te pikes b) te ketij neni, cdo organ administrativ është kopetent ne fushen qe ai mbulon dhe nuk mundet te ushtroje te drejatat e nje organi tjetër administrativ, pasi ne thelb ushtrimi i kopetencave tej kufijve te ligjit , perben cenim te parimit te ligjshmerise e per kete shkak akti administrativ i nxjere si pasoje e nje veprimtarie administrative te pakufizuar dhe ne cenim te ketij parimi, passjell pavlefshmerine e aktit.

Po keshtu ne kuptim te kesaj pike te dispozites, nje akt administrativ do te konsiderohet absolutisht i pavlefshem jo vetem a) kur organi administrativ nuk është kopetent apo ai b) kapercen kufijte e kopetences se tij ,por edhe kur c) çeshtja qe ai zgjidh nuk hyn ne juridiksionin e tij administrativ.

Neni neni 80.3.c, i Udhezimit 24 date 02.09.2008 “Per procedurat Tatimore” , e parashikon verifikimin ne vend si nje nga llojet e kontroleve tatimore qe ne vetvete është nje verifikim i shkurter qe synon zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje nder te tjera edheme perdorimin e pajisjeve fiskale, perditesimin e te dhenave te subjeteve, deklarimin e te punesuarve rishtas ne skemem e sigurimeve shoqerore etj....

Po keshtu, kjo pike e Udhezimit parashikon se keto verifikime kryhen pa njoftim paraprak te personave te tatueshem por vetem nepermjet prezantimit ne momentin e verifikimit te dokumentit personal te verifikuesit dhe urdherin e dites te leshuar nga Drejtuesi i Drejtorise se kontrollit per verifikime ne vend.

Ne rastin konkret sipas te dhenave te cituara ne aktin e konstatimit provohet se ndodhemi para nje kontrolli te tille te ushtruar ne baze te urdherit te punes date 06.01.2016 por ky kontroll është ushtarur nga Inspektoret e zbatimit te Task Force te Drejtorise se Pergjithshme te tatimeve dhe jo nga inspektoret e verifikimit ne teren te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe.

Lidhur me procedurat e ushtrimit te kontrollit per konstatimin e kundravajtjeve administrative ne perdorimin e pajisve fiskale, per leshimin e kuponeve fiskale dhe biletave ne piken 122.5 te Udhezimit nr 24 date 02.09.2008 “Per procedurat tatimore” parashikohet ne menyre te shprehur se :

Konstatimi, shqyrtimi dhe denimi i shkeljeve te parashikuara ne kete nen behen nga organet tatimore te juridiksionit, ku tatimpaguesi ushtron veprimtarine ose kryen shkeljet. Ne rastet kur strukturta qendrore te DPT disponojne infomacion ose ndermarin verifikime ne teren, verifikime dhe kontrole te tilla duhet te ushtrohen ne bashkepunim me strukturat perktese te organeve tatimore te juridiksionit.

Siç shihet nga formulimi i kesaj dispozite te ligjit , ajo i referohet nder te tjera konstatimit te shkeljeve te parashikuara ne nenin 122 te ligjit nr 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore”, ku nje nga shkeljet është ajo e parashikuar ne piken 1, germa d) te ketij neni sipas te ciles:

1. Tatimpaguesi person juridik ose fizik tregetar denohet ne rast se:

d) nuk afishon ne nje vend te dukshem nje poster qe tregon detyrimin e blesesit te mallrave apo te perfitueist te sherbimit, per te kerkuar kupon tatimor, me gjobe ne masen 20 000 leke.

Referuar te dhenave te aktit te konstatimit por edhe pohimeve te pales se paditur, nuk rezulton qe te jete vepruar ne perputhje me detyrimin e parashikuar ne piken 122.5 te Udhезimit per procedurat tatimore pasi kundravajtja eshte konstatuar nga Inspektore te Drejtorise se Hetimit tatimor, pa qene prezent nje perfaqesues i Drejtorise se juridiksionit, pra DRT Korçe.

Ne kete aspekt vleresohet se Inspektoret e Hetimit Tatimor kane kapercyer kufijte e kopetences se tyre duke mbajtur akt konstatimi pa qene prezent perfaqesuesi i DRT Korçe.

Pavaresisht faktit se eshte mbajtur porcesverbali i gjobes nga Inspektoret e DRT Korçe pasi kopetenca e shqyrtimit dhe denimit te shkeljeve te nenit 122 te ligjit i takon organit tatimor te juridiksionit ky kryen shkeljet, ai bazohet mbi te dhenat e aktit te konstatimit dhe rjedhimisht "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" konsiderohet akt absolutisht i pavlefshem pasi aktet qe e paraprijne ate jane absolutisht te pavlefshme, konform nenit 116/b te Kodit te Procedurave Administrative.

Ne analize te sa me siper çmohet pranimi i padise pasi pala e paditur nuk ariti te provoje vefeshmerine e aktit administrativ te nxjere prrej saj dhe faktet qe ka vendosur ne themel te vendimarjes pasi ndersa ne rastet e procedures ligjvenesit ka parashikuar se jo çdo shkelje e saj passjell nulitetin e aktit, per rastet e inkoptences nuk ka nje perjashtim te tille.

Ne veshtrim te nenit 45 germa a) te ligjit 49/2012 ky vendim eshte i paankimueshem pasi sipas kesaj dispozite.... *nuk lejohet ankim ndaj vendimeve perfundimtare te gjykates administrative per padi me objekt kundërshtimin e denimit per kryerjen e kundravajtjeve administrative me vlere me te vogel se 20-fishi i pages minimale ne shkalle vendi.* Ne baze te VKM nr. 573, datë 3.7.2013, "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", duke filluar nga muaji Korrik 2013 e ne vazhdim, paga bazë minimale mujore, për punonjësit në shkallë vendi, eshte 22.000 (njezet e dy mije) leke.

Lidhur me shpenzimet gjyqesore te takses mbi aktet ne shumen 3 000 leke te parapaguara nga pala paditese, konform nenit 106/1 te K.Pr.C i ngarkohen pales se paditur meqenese çmohet pranimi i padise.

PER KETO ARESYE

Gjykata bazuar ne nenin 40-42 dhe 45, te ligjit 49/2012 si dhe 116 te Kodit te Procedurave Administrative

VENDOSA

Pranimin e padisë se paditësit "Health Diagnositik Center Krasis", pale e paditur DRT Korçe, me objekt "Shfuqizimin tërësisht të akt njoftim vlerësimit tatimor nr 9521 prot date 25.02.2016 te nxjere nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe si dhe shfuqizimi e vendimit nr 8510/1 date 18.05.2016 te Drejtorise se Apelimit tatimor" duke u shfuqizuar Njoftim vlerësimit tatimor nr 9521 prot date 25.02.2016 i Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe, lene ne fuqi me vendim nr 8510/1 date 18.05.2016 te Drejtorise se Apelimit tatimor si akt ne kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ligji.

Shpenzimet gjyqesore ne shumen 3 000 leke i ngarkohen palës se paditur.

Ky vendim eshte përfundimtar dhe kundër tij nuk lejohet ankim.

Ushpall ne Korçe date 21.10.2016

Sekretare
Safjola Sadik



GJYQTARE
ETLEVA GJAMO

